



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija /
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

Datë 14. 06. 2021

KOMISIONI I PËRBASHKËT SHQIPËRI - KOSOVË PËR MIRATIMIT E TEKSTEVE
MËSIMORE PËR DIASPORËN

**THIRRJE PËR APLIKIM PËR RECENSENTË PËR VLERËSIMIN E TEKSTIT
MËSIMOR PËR MËSIMIN PLOTËSUES NË DIASPORË DHE MËRGATË,
NIVELI I**

1. Komisioni i Përbashkët Shqipëri–Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën, shpall thirrjen për aplikim **për recensentë për vlerësimin** e tekstit mësimor për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në Diasporë dhe në Mërgatë, me titullin **“Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” niveli I**.
2. Ftohen të aplikojnë individë që përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në **paketën e dokumenteve mbi procedurat e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për Diasporën**, miratuar në shkurt 2021 nga Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë i Republikës së Shqipërisë, Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, si dhe Ministri i Shtetit për Diasporën i Republikës së Shqipërisë.

3. Individit aplikues aplikon në linkun: <http://qbd.gov.al/aplikimeqbd/>

4. Aplikimet pranohen nga data 14 qershor – 9 korrik 2021.

5. Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

5.1. Specialist/ekspert sipas fushave:

- Dokument identifikimi;
- Jetëshkrimi (CV-ja);
- Diplomë e ciklit të dytë të studimeve në njërin nga fushat (gjuhë shqipe, letërsi, histori, gjeografi, kulturë muzikore, kulturë figurative);
- Dëshmi e gradave shkencore dhe/ose titujve akademikë (nëse ka);
- Dëshmi të botimeve, pjesëmarrjeve në konferenca dhe kontributeve në arsim dhe/ose shkencë;
- Dëshmi për përvojë në vlerësimin e teksteve mësimore (nëse ka);
- Vetëdeklarim mbi vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara.

5.2. Specialist/ekspert gjuhësor:

- Dokument identifikimi;
- Jetëshkrimi (CV-ja);
- Diplomë e noterizuar për ciklin e dytë të studimeve në gjuhë shqipe;
- Dëshmi të përvojës në redaktim gjuhësor në fushën e botimeve;
- Vetëdeklarim mbi vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara.

5.3. Mësues nga diaspora:

- Dokument identifikimi;
- Diplomë si mësues/mësimdhënës për ciklin fillor/klasor ose në njërin nga fushat e kurrikulës së mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë (gjuhë shqipe, letërsi, histori, gjeografi, kulturë muzikore, kulturë figurative);
- Dëshmi si mësues në diasporë;

- Dëshmi të përvojës së punës (së paku 5-vjeçare) si mësues i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare në diasporë;
- Dëshmi të kualifikimeve dhe trajnimeve në fushën e mësimdhënies (nëse ka);
- Vetëdeklarim mbi vërtetësinë e dokumenteve të dorëzuara.

6. Dokumentet duhet të ngarkohen në formatin pdf online në linkun:

<http://qbd.gov.al/aplikimeqbd/>

7. Për pyetje, lutemi na kontaktoni në adresën (info@qbd.gov.al)